

URDHËR
Nr. 96, datë 31.5.2024

**PËR CAKTIMIN E ZËVENDËSDREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR USHTRIMIN E KOMPETENCAVE DHE
DETYRAVE TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, Drejtues i Parë Sami Kuti, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, por jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendës drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë, Drejtues i Parë Sami Kuti.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla